

01-09



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05Nr.391/02-1819/24 dt. 04.01.2024, të kërkesit/pronarit, “Euro Miti” shpk, me seli në fshatin “Muhovc” rr. Magjistrale Prishtinë-Ferizaj, me përfaqësues Sait Grainca nga Ferizaji, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesën afariste të përkoshme, me destinim, pikë e shitjes së derivateve të naftes dhe market, në Hajvali në rr. “Gjilani” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 18.06.2024, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LEJOHET kërkesit / pronarit, “Euro Miti” shpk, me seli në fshatin “Muhovc” rr. Magjistrale Prishtinë-Ferizaj, me përfaqësues Sait Grainca nga Ferizaji, sipas kërkesës 05Nr.391/02-1819/24 dt. 04.01.2024, përdorimi i ndërtesës afariste të përkoshme me destinim, pikë e shitjes së derivateve të naftes dhe market, në Hajvali, me etazhitet P+0, e ndërtuar sipas “Vendimit të Lejes Ndërtimore”, 05Nr.351-210679/20 dt.26.01.2021, në parcelën kadastrale nr. 1374-0, e evidentuar në certifikatën e pronësisë P-71914002-01374-0, ZK Hajvali, në Prishtinë.

II. Ndërtesa nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugën “Gjilani” ku kanë dalje hyrjet e kësaj ndërtese me numrat: 262, në Prishtinë, dhe e njejta do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesës dhe njërive të saja në evidencat e regjistrit kadastral.

VI. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Kërkesi / pronari, “Euro Miti” shpk, me seli në fshatin “Muhovc” rr. Magjistrale Prishtinë-Ferizaj, me përfaqësues Sait Grainca nga Ferizaji, me kërkesën me 05Nr.391/02-1819/24 dt. 04.01.2024, i është drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën afariste të përkoshme, me destinim, pikë e shitjes së derivateve të naftes dhe market, në Hajvali, me etazhitet P+1, e ndërtuar në kuadër të parcelës kadastrale nr. 1374-0, ZK Hajvali, ndërtuar sipas “Vendimit të Lejes Ndërtimore” 05Nr.351-210679/20 dt.26.01.2021, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Spektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare “Akt përcjellës”, me referencë 09 Nr. 391/02-205370/23 dt. 22.12.2023, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizmit, Raportet e Inspeksionit Final të punëve dhe përshkrimin të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografi gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikqyrësi Adriatik Haziri / Flamur Grajçevci; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikqyrësi Besmir Musaj; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikqyrësi Arban Shala; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikqyrësi Osman Mehmetukaj; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të makineris, nga mbikqyrësi Zenun Shala; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licensuar Faton Bejselmani me nr. të licensës 125;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa e përkoshme afariste auto-servis mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa e përkoshme me destinim, pikë e shitjes së derivateve të naftes dhe market mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesën e përkoshme afariste.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Vendim, përmes kësaj Drejtorie, me ankesë mund t'i drejtohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, brenda afatit prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

I dorëzohet: Kërkesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,

05 NR. 391/02-1819/24 DT. 18.06.2024

Zyrtarja,
Bahtije Vllasaliu
B. Vllasaliu

Udhëheqëse e Sektorit,
Nazife Krasniqi



Faqe 2 prej 2